L I G J
Nr.7852, datë 29.7.1994

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993, në lidhjen nr.1 "Niveli i taksave portuale në Republikën e Shqipërisë", te shënimi, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"Taksat portuale për tragetet e shoqërisë "Adriatika" të jenë ato të vendosura ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Italisë në protokollin "Për vendosjen e shërbimit detar të linjës me anije trageti për transportimin e kamionëve të mallrave, të mallrave e të dërgesave postare midis portit të Durrësit dhe portit të Triestes" nënshkruar në Tiranë më 22 tetor 1983.

Ky nivel taksash do të zbatohet deri në miratimin e marrëveshjes së re nga të dy qeveritë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren Zyrtare" dhe efektet e tij i shtrin që nga data 19.3.1993.

Shpallur me dekretin nr.911, datë 16.8.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.